

VENDIM
Nr. 92, datë 21.2.2024

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
NDËRQYTETËS TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 4 e 5, të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të nenit 10, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus janë sipas përcaktimeve në shtojcën numër 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Në vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, tarifat e transportit rrugor ndërqytetës shfuqizohen.
 3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe subjektet e licencuara për operim në linjat e rregullta të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
TARIFAT E BILETAVE TË TRANSPORTIT NDËRQYTETËS TË UDHËTARËVE ME
AUTOBUS SIPAS DISTANCËS KILOMETRIKE

Nr.	Distanca kilometrike (km)	Çmimi i biletës vajtje ose ardhje (lek)
1	÷ 10	50
2	÷ 15	75
3	÷ 20	90
4	÷ 25	120
5	÷ 30	145
6	÷ 35	170
7	÷ 40	190
8	÷ 45	220
9	÷ 50	235
10	÷ 55	255
11	÷ 60	280
12	÷ 65	305
13	÷ 70	335
14	÷ 75	365
15	÷ 80	395
16	÷ 85	415
17	÷ 90	445
18	÷ 95	475
19	÷ 100	500

20	$\div 110$	525
21	$\div 120$	570
22	$\div 130$	595
23	$\div 140$	655
24	$\div 150$	700
25	$\div 160$	740
26	$\div 170$	785
27	$\div 180$	830
28	$\div 190$	870
29	$\div 200$	910
30	$\div 210$	945
31	$\div 220$	990
32	$\div 230$	1030
33	$\div 240$	1090
34	$\div 250$	1135
35	$\div 260$	1175
36	$\div 270$	1220
37	$\div 280$	1250
38	$\div 290$	1280
39	$\div 300$	1300
40	$\div 310$	1350
41	$\div 320$	1400
42	$\div 330$	1450

Shënim. Në çmimin e biletës përfshihet edhe TVSH-ja.